REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA HIMARË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 02 prot. Himarë, më 11.02.2025

**PROCESVERBAL**

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKHAK HIMARË, ZBARDHUR NGA ORGJINALI. MBLEDHJE E MBAJTUR JASHTË RADHE , ME KËRKESË TË KRYETARIT TË BASHKISË .**

Sot më datë 11.02. 2025 zhvillohet mbledhje jashtë radhe e Këshillit Bashkiak Himarë , ora 12:00, mbledhje e hapur.

Marrin pjesë këshilltarët;

1.Dhimitër Kapaj , 2. Mirka Gjiçali, 3.Timoleo Gërdhuqi, 4 . Milto Nika , 5.Nertila Husi, 6. Loreta Isufi , 7. Thodhori Foto, 8. Elisabeta Lamaj, 9. Gjergji Iliadhi, 10.Silva Burbo, 11. Gjergji Iliadhi, 12.Afrovita Dhimojani, 13. Lenica Kocani, 14. Maks Vlashi, 15. Artan Bala, 16. Qirjako Mërkuri , 17. Aleks Llazari, 18.Fuat Mati, 19. Miltiadh Prifti.

Mungojnë ; 1. Nikolin Laska, 2. Artionil Shirokaj

Plotësohet Kuorumi këshillit.

Hap mbledhjen kryetari këshillit.

Këshilltarët shprehen se duan të jetë prezent kryetari Bashkisë padi kjo mbledhje është me kërkesën e tij.

Kryetari këshillit :- Në rregull , presim disa minuta, por kryetari është në një mbledhje pune të rëndësishme.

Në mbledhje marrin pjesë dy nënkryetarët e Bashkisë, administratorët, drejtoritë, kryetarët e disa fshatrave.

Fillon mbledhja.

**Pika 1. Për miratimin dhe shqyrtiminve sezonit turistik dhe planit të veprimit përkatës për bashkinë e Himarës për vitin 2025.**

**Znj.Afrovita Dhimojani:-** Në këtë projekt që na keni sjell që janë hartat për stacionet e plazheve dhe lejet e bixhbareve, lejet e bixhbareve jepen nga ministria , referuar nga çfarë kam parë në teren , ku merren leje për bixhbare edhe kthehen në restorante, a ka kontroll nga bashkia për sipërfaqet që merren me leje , se kjo është një problematikë për sezonin turistik?

**Sqaron drejtori Sokrat Kreku:-**Piketimi bëhet nga sipërfaqet që kanë marrë , bashkia I etiketon këto raste dhe u kemi dërguar shkresën dhe marrë masa ku ka patur abuzime.

**Z.Fuat Mati:-** A ka limt sa metra nga vija bregdetare duhet të jetë leja? Drejtori :- Këtë procedurë e miraton ministria.

**Znj.Afrovita Dhimojani:-** te grupi punës që përcakton bashkia për monitorim duhet të ketë edhe nga anëtarët e këshillit.

**Drejtori :-** të konsultohemi me drejtorin juridike për këtë , pasi këtë monitorim e bën policia Bashkiake.

**Kryetari këshillit:-** Zonja këshilltare nuk je dakord me lejet apo?

Z.Afrovita Dhimojani :- Unë fola që aq sa sipërfaqe merret aq të mbaj, fola për shkelje , sepse kanë abuzuar .

**Drejtori:-** Ku ka patur shkelje kemi reaguar.

I bashkohet mbledhjes kryetari Bashkisë ( ndjesë për vonesën)

**Z.Afrovita:-** Kryetar po flisja për sezonin turistik , meqenëse ujë vret disa shkelje në monitorimin e punës propozova në lidhje me zonat që jepet leje për bixhbaret këto leje shkelen, dhe propozoj në grupin e punës të ketë përfaqësues edhe nga këshilli për monitorim .

**Kryetari Bashkisë :-** këto leje nuk I jep bashkia dhe nuk I miraton bashkia, këtë shqetësim e kam edhe unë, u jam drejtuar institucioneve përkatëse , kemi kërkuar nga subjektet duke u lënë afat 10 ditë dhe kush ka qënë në shkelje , abuzuar ne do të veprojmë vetë në këto subjekte dhe ata që kanë shkel kontratën nuk do tu përsëritet kontrata , po për monitorim në tërësi të jeni edhe ju.

**Z.Qirjako Mërkuri:** - Në këto lejet që keni dhënë për bixhbaret sa % janë banorë të Bashkisë Himarë?

**Drejtori:-** Janë te 60% , ne duam zhvillim të marrën banorët vendas , pse të vijnë të huaj dhe kryetari të ndikojë pak…përfundon z.Qirjako.

**Kryetari Bashkisë:-** Pse jo, të sensibilizohen qytetarët të plotësojnë kriteret dhe të aplikojnë.

Z.Fuat Mati :- Në djenin time afati për këtë procedurë ka mbaruar për plazhet, për bixhbaret është në vazhdim.

Z.Timoleo Gërdhuqi :- Nuk na u sqarua pse është çuar kjo pikë nuk u shqyrtua radhën e parë apo ka shtesa? Kjo pikë u shqyrtua dhe e hedhim në votim.

Sekretari Këshillit: - kemi protokollin dhe regjistrimin se kjo pikë nuk është shqyrtuar plotësisht, u la për mbledhjen e radhës.

Znj.Thëllëza Kokaveshi:-Fluksi parkimeve si do të zgjidhet ? Ne e dimë sa hapsirë ka bashkia sepse e dimë sa është fluksi dhe ka nevojë , cilat zona janë caktuar nga bashkia dhe çfarë masash janë marrë?

Drejtori :- ARSHK i ka kaluar Bashkisë Himarë një korsi dhe e kemi në menaxhim, problematik kemi gjobat për plazhet sepse vija bregdetare është pjesë e plazheve , te rruga kryesore dalin 600 vende makinash.

**Kryetari Bashkisë:** Te fusha e sportit fillon një investim për parkimet , sivjet do t'i menaxhojmë, do ti marrim me pagesë për banorët do të kemi kartën e banorit.

Kryetari Këshillit :- A do të ketë parkime me qëra në bashkinë Himarë?

Kryetari Bashkisë :- do të gjejmë një mënyrë menaxhimi.

Znj.Thëllëza Kokaveshi :- Tek pjesa e pastrimit qytetarët faktor kyç dhe bizneset janë caktuar si rregullore , a është bërë ndonjë dëgjesë publike, a janë në djeni bizneset për oraret e nxjerrjes së mbeturinave? Të tria njësitë për pastrimin kanë një shumë të lart në buxhet por fuqia e punës të shtohet gjatë sezonit dhe sa kontrolluese është bashkia në këto firma?

Sqaron drejtori…

Kryetari Këshillit:- A ka një datë të caktuar që firma do të kalojë të mbledh mbeturinat?

Znj.Silva Burbo :- Sezoni turistik ks shumë fluks , mbeturinat janë para koshave , marrëveshja e firmave për mbledhjen e mbeturinave në verë për bizneset duhet orari , duhet të jetë natën ose afer mëngjesit , jo në orare dreke dhe për qytetarët që nuk disiplinohet duhet të ketë gjoba.

Z.Aleks Llazari :- Në vendin e quajtur Kllon – verdhë na nevojiten dy kosha , po – Kryetari. Sqaron drejtori :- ne diskutuam dhe shtuam edhe kosha ama qytetarët nuk janë të përgjegjshëm **.**

**Kryetari Bashkisë :**-deri në tetor jemi vlerësuar si bashkia më e pastër nga Giz në Shqipëri që më është bërë qejfi dhe jeni në prag të miratimit të kontratës së re .

Znj. Silva Burbo :- për ndotjen akustike, a ka ndonjë aparat për matje zhurme, kryetari :- në prill.

**Z.Timoleo Gërdhuqi :-** këshilltarët duhet të dinë kompetencat e tyre, nuk shoh asnjë këshilltar apo grup të dal me propozime , flasim për parkime, asgjë e kemi ne të vendosim për parkime privat , ne sot jemi për masa paraprake të sezonit

**Z.Milto Nila:-** A ka një zonë në bashki që është e pa zabtuar? Për zonën tonë turizmi nuk zhvillohet vetëm në vijën bregdetare por edhe në thellësi të fshatrave.

**Z. Fuat Mati :-** Bashkia të marrë masa për rrugën në plazhin e Borshit .Sqaron Kryetari Bashkisë:- marrëveshja ka filluar deri sa të fillojë I plotë investimi shëtitorja e Borshit do të bëhet e plotë shumë shpejt , do mbarojnë rrugët paralele e pastaj shëtitorja.

**Z.Maks Vlashi :-** Për pjesën nga Krekza deri në Kakome ?

Kryetari Bashkisë ;- e ka ARSHK nuk e kemi ne.

**Z.Timoleo Gërdhuqi:-** Drejtoria e shërbimeve të bëj një njoftim , nëse ka banorë për tokat e tyre që duan ti japin për parkim me qëra .

**Kryetari këshillit :-** kemi fatin e madh se kemi miratuar drejtori të re shërbimesh, ndriçimi lë për të dëshiruar,shpresojmë të funksionojë më mirë në të ardhmen .

**Znj. Afrovita Dhimojani:-** Tek pjesa e ndriçimit juve thatë se kemi projekt për ndriçimin , ne nuk e kemi parë këtë projekt , duam të dimë se si, ku do të shkojë ky ndriçim?

**Kryetari Bashkisë :-** Ndriçimi do të shkojë në çdo shtëpi, rrugë , lagje, biznese e të tj.Ne jemi duke punuar, është me faza , në shkurt hapet procedura , lidhen afatet ligjore dhe pastaj fillon puna.

**Znj.Afrovita Dhimojani :-** Sa i përket projektit e ndriçimit e duam në mbledhjen e radhës.

**Kryetari Këshillit :-**E hedhim në votim, sa janë pro, kundra, abstenim?

**Miratohet vendimi nr.07 për menaxhimin e suksesshëm të sezonit turistik dhe masat e marra për vitin 2025 me 18 vota pro , 1 kundër ( Timoleo Gërdhuqi) zero kundër.**

**Pika 2 . Për korrigjimin e gabimit të materialit të vendimit nr.1 datë 30.01.2025 për PBA.**

**Znj.Silva Burbo :-**te shpenzimet e kontratës Horë – Vranisht , Himarë janë bashkë , është gabim teknik apo? **Drejtor Laert Mezani:-** është gabim teknik , tek PBA duhet të përcaktojmë të gjithë planin e menaxhimit vjetor , tek projektvendimi më pashëm mungojnë këto paragrafe , nuk janë përcjellë.Himarë – Horë – Vranisht do jenë bashkë dhe Lukovë veç.

Znj.Afrovita Dhimojani :- Cilat janë pikat më primare për 2025 ?

**Sqaron drejtori Laert Mezani**

Krahësh koshave, riciklimit , janë këto e shumë të tjera , zons në Vish për inertet? :- Afrovita.

**Kryetari Bashkisë :-** është dhënë urdhër të restaurohet e më vonë të mbyllet ajo pike dhe të gjendet një vend tjetër dhe ju do ta miratoni.

Z.Timoleo Gërdhuqi:- PBA 2025 – 2026 mos ka kaluar vjet?

**Drejtori Laert Mezani :-** PBA – nuk ka ndryshuar.

**Z.Timoleo Gërdhuqi :-** TE lagjia Vonaj është një rrugë për t'u futur në plan , rruga kryesore Borsh – Sarandë në lagjen e banorëve Micaj .

**Kryetari Bashkisë :-** Të futet në PBA edhe rruga në fshatin Çorraj .

**Kryetari fshatit Ilias:-** kërkon kosha shtesë për mbeturinat, sinjalistika ku të orientohen turistët

**Kryetari Bashkisë:- Po.**

**Kryetari Këshillit :- E hedhim në votim? Sa janë pro, kundër, abstenim?**

**Miratohet vendimi nr. 08 për korrigjimin e vendimit nr.01 datë 30.01.2025 për PBA- në me 19 vota pro , zero kundër, zero abstenim**

Kryetari këshillit mbyll mbledhjen.

**Sekretari Këshillit**

**Elena Memushaj**